

URDHËR
Nr. 82, datë 24.4.2026

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS ZËVENDËSMINISTRIT PËR
NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME KORPORATËN E
INVESTIMEVE SHQIPTARE, NË KUADËR TË PROJEKTIT TË INVESTIMIT
“QENDRA PËR ZHVILLIMIN MULTIFUNKSIONAL, TIRANË” DHE DISA
RREGULLA PËR ZBATIMIN E SAJ**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 11, të pika 2, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të nenit 6, pika 2, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të vendimit nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, të ndryshuar; si dhe të vendimit nr. 119, datë 27.2.2026, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin të Korporatave të Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e projektit të investimit ‘Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore’, me nënprojektet si ‘Korpusi i institucioneve të pavarura’, ‘Qendra për Zhvillimin Multifunksional, Tiranë’”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së titullarit të Partnerit Publik, Ministria e Punëve të Brendshme, zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, znj. Anisa Ruseti, për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Korporatën e Investimeve Shqiptare, në kuadër të projektit të investimit “Qendra për Zhvillimin Multifunksional, Tiranë”.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në inventarin e së cilës ndodhen pronat që transferohen sipas marrëveshjes, të ndjekë realizimin e procedurave për vënien në dispozicion dhe dorëzimin e pronave, sipas përcaktimeve të marrëveshjes dhe legjislacionit në fuqi.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Garda e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e përfituesve kryesorë nga projekti i investimit, të bashkëpunojnë me Korporatën e Investimeve Shqiptare dhe të ndjekin procedurat e tjera në zbatim të detyrimeve të parashikuara në marrëveshje, përfshirë përcaktimin e nevojave dhe specifikimeve teknike, lidhur me projektin.

4. Ngarkohen zëvendësministri i Punëve të Brendshme, znj. Anisa Ruseti, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij urdhri.

5. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Punëve të Brendshme për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari